



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.266/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj-kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.266/2025 e datës 30.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më gjelbëri në lartësi prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) euro.

II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjelbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 30.01.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.266/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 30.01.2025, aktivisti dhe mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj ka publikuar në rrjetin social, ku vërehet i vendosur banesri/posteri i kandiadit per deputet te LVV Albin Kurti e vendosur ne hapësira publike, pa lejen dhe pëlqimin e pronarit/shfrytëzuesit te kësaj hapësire, i njëjti thekson se vendosja e këtij posteri ne hapësirat publike, pa lejen dhe pëlqimin e drejtorisë përkatëse te Komunës se Skenderajt përbënë shkelje te LZP-së.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim subjekti politik LVV ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*” Si provë ka bashkangjitur, fotografi që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 31.01.2025, subjekti politik LVV ka kundërshtuar ankesën e paraqitur dhe ka kërkuar nga PZAP që ta refuzojë si të pa bazuar ankesën duke theksuar se per këtë ka pëlqimin e pronarit te parcelës, nga ku ka bashkangjitur si dëshmi një shkrese me emërtimin pëlqim ne te cilën theksohet se jepet pëlqimi për vendosjen e posterave ne muret e banese si hapësirë reklamuese. Si provë ka bashkangjitur adresimi i Partisë Demokratike e Kosovës përmes rrjetit social facebook, të datës 17.01.2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik i LVV ka shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore hapësirat publike konkretisht hapësirat/rrugët publike. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht nen 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parashev: “*1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*”, andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00€). Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00€).

Paneli me rastin e shqyrtimit ka vlerësuar edhe përgjigjen ne ankesë te subjektit politik LVV dhe ka vlerësuar se pëlqimi i bashkangjitur nuk ka mundur ta merr për bazë me rastin e vendosjes për këtë çështje, kjo pasi që ky pëlqim nuk është lidhur para organeve kompetente dhe nuk paraqet dokument zyrtar. Paneli ka gjetur se kemi të bëjmë me vendosje të postereve në hapësira publike, shfrytëzimi i të cilave mund të bëhet për qëllime të tilla por që paraprakisht duhet të merret leja nga organet kompetente të komunës.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.266/2025 më datë 01.02.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.